# DËSHMI ARKIVI

**A-472965**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Hallgrimsson korrigjon deklaratën për “gjenocidin” para përballjes me Izraelin |
| ADRESA | `https://albeu.com/sport/hallgrimsson-korrigjon-deklaraten-per-gjenocidin-para-perballjes-me-izraelin/1029123/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 06:44:13 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 06:39:41 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `fe3a9e98693da569f31975c91ea5174eeceff1612f6f75c8d46562bc17ace0b2` |
| TEKSTI | `e6dffe3fa91255209d89da38795bc8c940f01646b9e59119da8666ec66f1f2ae` |
| PAMJA | `0a94b1e2c31c874a646d739ffd62e9ba15c94c49a76c579f6787805fb3b15706` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `fa73aec6724a4503866e8f17ccf4e775893db1d7ba5485ba53e364083d013904` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f5063896df89cef7c197e5d003e6be2f1d9963e4417c199c978c5a8c380b40e8` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/fa73aec6724a4503866e8f17ccf4e775893db1d7ba5485ba53e364083d013904`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Hallgrimsson korrigjon deklaratën për “gjenocidin” para përballjes me Izraelin



Heimir Hallgrimsson, trajneri i Kombëtares së Irlandës, është rikthyer te komentet e tij për situatën në Gaza, duke pranuar se përdori një term “të fortë dhe të gabuar” përpara ndeshjes së Ligës së Kombeve kundër Izraelit.

I pyetur nëse ishte penduar që e kishte cilësuar veprimin e Izraelit si gjenocid, Hallgrimsson tha se e kuptonte peshën e fjalës së përdorur.

“Patjetër që përdora një fjalë të fortë. Mediat irlandeze e njohin shumë mirë të gjithë historinë. Që nga shorti i muajit shkurt, kjo çështje ka qenë pjesë e vazhdueshme e konferencave tona për shtyp, pavarësisht kundërshtarit me të cilin do të përballeshim”, u shpreh ai.

Sipas trajnerit, në Irlandë ekziston një mbështetje e gjerë për Palestinën, ndërsa kundërshtimi ndaj zhvillimit të ndeshjes ka nisur që pas shortit.

“Në Irlandë ka një mbështetje shumë të madhe për Palestinën, ndoshta ndër më të mëdhatë në Evropë. Që nga hedhja e shortit janë organizuar protesta kundër zhvillimit të kësaj ndeshjeje”, deklaroi Hallgrimsson.

Ai tha se presioni publik kishte ardhur duke u shtuar si ndaj futbollistëve, ashtu edhe ndaj federatës, ndërsa theksoi se këtë situatë e kishte përjetuar edhe vetë.

“Protestat në Irlandë kundër zhvillimit të ndeshjes kanë nisur që ditën e parë. Lojtarët dhe federata do ta ndiejnë këtë presion. Unë e kam parë se si ai është rritur nga dita në ditë dhe tani pothuajse ka arritur një pikë kritike. Vetë slogani i protestuesve përmban atë fjalë. Prandaj, kur e përdora atë shprehje, dhe po e përsëris, zgjodha një fjalë të fortë dhe të gabuar”, tha trajneri irlandez.

Hallgrimsson nënvizoi se dalja në fushë nuk duhet të shihet si një miratim i asaj që po ndodh në Gaza.

“Fakti që luajmë nuk do të thotë se pranojmë atë që po ndodh. Nëse një lojtar zbret në fushë nesër, kjo nuk

të fundit/


Ngushtica e Hormuzit mbetet e mbyllur, Trump refuzon ofertë…


Kosova synon rezultat pozitiv në transfertën ndaj Austrisë


Protesta qytetare hyn në ditën e 120-të, kërkohet dorëheqja e…


Këmbimi valutor/ Me sa blihen e shiten dollari dhe euro, çfarë ndod…


BE-ja akordon 710 milionë euro për njerëzit e prekur nga…


Kthjellime dhe alternime vranësirash mesatare/ Parashiki…


Austri–Kosovë në Vjenë: Të gjitha zhvillimet, minutë pas…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

nënkupton se ai e pranon, e mbështet apo pajtohet me atë që ka ndodhur në Gaza. Vetë pjesëmarrja jonë në ndeshje është një deklaratë", u shpreh ai.

Trajneri sqaroi se Irlanda po luan për shkak të rregullave të kompeticionit, duke theksuar se skuadra nuk po luan "bashkë me dikë", por përballë një kundërshtari.

"Ne nuk po luajmë së bashku me dikë, por kundër dikujt. Nëse mund të përcjell ndjenjat e lojtarëve dhe t'u përgjigjem pyetjeve për mbrojtjen e tyre, ata ndihen sikur po bëjnë diçka të gabuar duke luajtur këtë ndeshje nën presionin e njerëzve në Irlandë", deklaroi Hallgrimsson.

Ai shtoi se futbollistët ndihen keq kur përballen me kritika nga njerëzit për të cilët duan të luajnë.

"Është e vështirë të jesh nën presionin e njerëzve të tu, të cilëve dëshiron t'u luash. Për këtë arsye duam ta bëjmë të qartë se nuk e mbështesim atë që po ndodh në Gaza", tha ai.

"Kjo ndeshje zhvillohet sepse kështu përcaktojnë rregullat e sportit dhe të kompeticionit ku marrim pjesë. Kjo është arsyeja pse ndodhemi këtu dhe duam t'i respektojmë këto rregulla", përfundoi Hallgrimsson.

Irlanda dhe Izraeli do të përballen më 27 shtator dhe 4 tetor.

Shtuar më 27.09.2026 08:39

Tags: Heimir hallgrimsson , Kombëtarja e irlandës , Liga e Kombeve , Përfaqësuesja e izraelit


Kosova synon rezultat pozitiv në transfertën ndaj Austrisë



Austri–Kosovë në Vjenë: Të gjitha zhvillimet, minutë pas minute


Pas 30 vitesh njohje, Foda dhe Rangnick përballen për herë të parë si trajnerë


Maran feston debutimin fitues me Shqipërinë: Një nisje më të mirë nuk mun…


Uzuni pas fitores me Bjellorusinë: Për Kombëtaren luaj në çdo…


Muçi pas suksesit ndaj Bjellorusisë: Ende nuk e di nëse e kam fituar vendin…


Asllani pas fitores ndaj Bjellorusisë: Ishte rival i vështirë, Manaj më kishte…



Rolando Maran nis me fitore aventurën te Shqipëria: Muçi i…

albeu që nga viti 2003 © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko... Kërko



© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.